Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike të Materialeve:

1) Parket druri për sipërfaqe sportive. Parketi të jetë me profile druri solid me trashësi ≥ 20 mm, me dru lisi ose ahu të stazhionuar, e punuar mashkull dhe femër, me gjatësi 40-50cm dhe gjerësi 6-8 cm, të vendosura në kurriz peshku ose sipas udhëzimeve në projekt, duke përfshirë armaturën e poshtme prej druri të seksionit 5 x 7 cm, të fiksuara me mbajtëse me vida e upa) dhe llaç çimentoje dhe të vendosura në interaks në mënyrë të rregullt. Pas vendosjes së parketit, bëhet lëmimi, stukimi dhe ilustrimi i dërrasave duke përdorur llak poliuretani transparent. Ky produkt duhet të ketë vetë të mira mekanike dhe rezistencë të lartë ndaj detergjentëve larës. Të bazohet në përbërje me polimer poliuretani të vetë-lidhjes dhe të arrijë në një kohë sa më optimale një ngurtësi të lartë të sipërfaqes me rezistencë të lartë ndaj gërryerjeve. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm për lyerjen e parketeve të drurit në palestra sportive duke pasur një koeficient rrëshkitshmërie sa më të ulët.

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standartin Shqiptar SSH EN 14342 ose ekuivalentin e tij, lidhur me Dysheme druri dhe parket - Karakteristikat, vlerësimi i konformitetit dhe marketimi.
- Standartin Shqiptar SSH EN 14904 ose ekuivalentin e tij, lidhur me sipërfaqet e brendshme të ambienteve sportive.

2) Dritaret d/al plastike. Profilet e dritareve duhet të përbëhen nga material Poly Vinyl Chloride (PVC) me gjerësi 70 mm deri 90 mm, do të fiksohen në mur me fasheta metali përpara suvatimit. Komizat PVC do të jenë të pajisura me mentesha dhe bllokuesit e ankoruar. Korniza e dritares PVC do të vidhohet me kasen mbas punimeve të suvatimit dhe bojatisjes. Kanatet me xham të hapshëm do të fiksohen me dritaren në tre pika të ankoruara doreza dhe bllokues. Të ketë ulluqe të mbledhjes së ujit, përforcues hekuri i galvanizuar, ulluk prej gome, doreza dhe bllokues të ankoruar në të, ngjithësisht special leshi për izolimin. Sipas kërkesës së investitorit, Panelet e xhamit (4mm-6mm të trasha) dhe dritaret prej PVC të jenë me xham dopio (20-24mm). Koeficient i percjelljes të temperaturës: deri në $U_f \leq 1.5$ W/m²K.

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standartin shqiptar SSH EN 14351-1 ose ekuivalenti i tij, në lidhje me dyer dhe dritare - Standardi i produktit, karakteristikat e performancës.
- Standartin shqiptar SSH EN 13501-1 ose ekuivalenti i tij, në lidhje me klasifikim zjarri i materialeve të ndërtimit dhe elementëve të ndërtimit - Pjesa 1: Klasifikimi që përdor të dhënat e provave nga reagimi ndaj provave të zjarrit.

3) Bojë hidroplastike cilësi e lartë. Bojë akrilike me cilësi të lartë akrilike. Boja duhet të jetë me rezistencë ndaj agjentëve të jashtëm si fërkimi apo larja. Boja do të aplikohet nga kontraktuesi sipas ngjyrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe të re apo të vjetër si suva, beton, etj. dhe të ketë shkallë të lartë mbulimi.

Karakteristikat teknike të përgjithshme:

- Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) akriliku
- Viskoziteti: 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja: ≤ 5 orë
- Norma e hapjes: ≥ 15 m²/litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm)
- Peshë specifike: 1.5 ± 0.2 kg/litër
- Pamja estetike: Mat, pa shkëlqim
- Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 25 g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënie e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme”.
- Standartin Shqiptar SSH EN ISO 11998 ose ekuivalentin e tij lidhur me bojra dhe llaqe - Përcaktimi i rezistencës në fërkim të lagët i veshjeve dhe aftësia për t’u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyerjes.

4) Automat (ndërprerës qarku). Një ndërprerës qarku është një pajisje sigurie elektrike e krijuar për të mbrojtur një qark elektrik nga dëmtimi i shkaktuar nga një mbirrymë ose qark i shkurtër. Funksioni i tij themelor është të ndërpresë rrjedhën e rrymës për të mbrojtur pajisjet dhe për të parandaluar rrezikun e zjarrit. Ndryshe nga një siguresë, e cila funksionon një herë dhe më pas duhet të zëvendësohet, ndërprerësi mund të rivendoset (me dorë ose automatikisht) për të rifilluar funksionimin normal. Ndërprerësit e qarkut janë të madhësive të ndryshme, nga pajisje të vogla që mbrojnë qarqet me rrymë të ulët ose pajisje shtëpiake individuale. Funksioni i përgjithshëm i ndërprerësit ose siguresës, si një mjet automatik për heqjen e energjisë nga një sistem me defekt, shpesh shkurtrohet si OCPD (Pajisja mbrojtëse mbi rrymën).

Karakteristikat teknike të përgjithshme:

- Tensioni i punës 220V
- Frekuenca 50/60 Hz
- Shkalla e mbrojtjes IP20
- Numri i çkyçjeve elektrike $< 10,000$ cikle
- Seksioni maksimal i lidhjes 0.75-35 mm²
- Kurba e çkyçjes C
- Tensioni i izolimit < 440 V

- Tensioni impulsiv i qëndrueshmërisë < 4kV
- Temperatura e punës -25°C ~ +55 °C

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standardin shqiptar: SSH IEC 60898-1 ose ekuivalentin e tij në lidhje me pajisjet ndihmëse elektrike - Ndërprerësit e qarkut për mbrojtjen nga mbirryma për instalimet shtëpiake dhe të ngjashme me to - Pjesa 1: Ndërprerësit për funksionim në qarkun e rrymës alternative.
- Standardin shqiptar: SSH IEC 60947-2 ose ekuivalentin e tij në lidhje me pajisjet shpërndarëse dhe kontrolli të tensionit të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut.

5) Automat diferencial. Ndërprerësi i rrymës së mbetur ose RCCB është në thelb një pajisje që ndjen rrymën dhe shkëput çdo qark të tensionit të ulët (rrymë të pabarabartë) sa herë që ndodh një defekt. Qëllimi kryesor i instalimit të një ndërprerësi të rrymës së mbetur është në thelb të mbrojë njerëzit nga goditjet elektrike ose dëmtimi i shkaktuar prej tyre. Ai shmang aksidentet duke shkëputur qarkun kryesor vetëm në një fraksion të sekondës. Puna e pajisjeve elektrike RCCB bazohet në parimin e Kirchhoff, që do të thotë se rryma hyrëse dhe dalëse në qark duhet të jenë të barabarta.

Karakteristikat teknike të përgjithshme:

- Tensioni i punës 230/400V
- Frekuenca 50/60Hz
- Rryma nominale e veprimt (I_{Δn}): 30 mA
- Numri i poleve 2
- Temperatura e punës -25°C ~+55 °C

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standardin shqiptar: SSH IEC 61008-1 ose ekuivalentin e tij në lidhje me ndërprerësit automatikë që veprojnë me rrymë residuale pa mbrojtje integrale të mbirrymës për përdorime shtëpiake ose të ngjashme me to (RCCBs) -Pjesa 1: Rregulla të përgjithshme.
- Standardin shqiptar: SSH IEC 61008-1-2 ose ekuivalentin e tij në lidhje me ndërprerësit automatikë me rrymë të mbetur pa mbrojtje integrale nga mbirryma për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme (RCCB). Pjesa 2-1: Zbatueshmëria e rregullave të përgjithshme për RCCB-të funksionalisht të pavarura nga tensioni i linjës.

6) Përcjellës rryme elektrike. Përcjellësi me izolim ose mbështjellës PVC është rezistent ndaj flakës, një cilësi e rëndësishme për kabllot elektrike në shumicën e përdorimeve. Përcjellës me izolim PVC është rezistent ndaj një game të gjerë kimikatesh, duke përfshirë vajrat, acidet dhe alkalet, dhe është i fortë, i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj gërryerjes. Temperatura në të cilën përcjellësi funksionon në parametrat e kërkuara varion zakonisht nga -15 në 90°C, si dhe ofron rezistencën ndaj dritës së diellit, reduktimin e emetimit të tymit dhe përmirësimin e rezistencës ndaj ujit.

Karakteristikat teknike të përgjithshme:

- Materiali Cu .PVC 0.4-1 kV,f leksibel
- Me tension maksimal 1200 V,
- Temperature maksimale pune 90°C
- Temperatura maksimale per LSH 250°C
- Temperature minimale pune - 15°C
- Forca maksimale ne terheqje 50 N/mm²

-
- Trashesia e izolacionit jo më pak se 0.7 mm,
 - Rezistenca elektrike ne 20°C 7.98 (Ohm/km),
 - Me rryme maksimale te lejuar ne ambient te hapur 28 A per temperature 30°C

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standardin shqiptar: SSH EN 50575 ose ekuivalentin e tij në lidhje me kablllo të fuqisë, kontrollit dhe komunikimit - Kablllo për zbatime të përgjithshme në ndërtim, subjekt i kërkesave të reagimit ndaj zjarrit.

7) Prozhektor. Prozhektor LED me ndriçim të bardhë. Projektor të ketë ndriçim me rreze të gjerë dhe me intensitet të lartë. Të jetë i përshtatshëm për të ndriçuar fushat e lojës, dhe ngjarje sportive gjatë kushteve me dritë të ulët.

Karakteristikat teknike të përgjithshme:

| | |
|--------------------------|---|
| Jetëgjatësia: | ≥ 20 000 orë |
| Fuqia: | 200 W – 300 W |
| Tensioni: | AC: 220-240 V |
| Frekuenca: | 50/60 Hz |
| Fluksi i ndritshëm (lm): | ≥ 20000 lm |
| Materiali: | Metal prej alumini ose inoks |
| Koha e fillimit: | 100% Aktiv në 0,001 sek (aktiv në çast) |
| Ciklet e ndezjes/fikjes: | ≥ 15000 |
| Kushtet e punës: | -20° +45° |
| Vlerësimi IP: | IP65 |

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standardin shqiptar: SSH EN 60598-1 ose ekuivalentin e tij në lidhje me ndriçuesit - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme dhe provat.
- Standardin shqiptar: SSH EN 61547 ose ekuivalentin e tij në lidhje me pajisjet për qëllime të përgjithshme ndriçimi - Kërkesat për imunitetin dhe përputhshmërinë elektromagnetike.

Grafiku i Punimeve:

Eshte paraqitur në Shtojcat bashkangjitur DST.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Qëllimi dhe detyrat:

Eshte paraqitur në Shtojcat bashkangjitur DST.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

SHËNIM: Grafiku i zbatimit të punimeve është paraqitur në Shtojcat bashkangjitur DST.

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3. Afati i realizimit</i> | | | | |
|----------|---------------------|------------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Nr | Përshkrimi i Punëve | Java 1/Muaji 1 | Java 2/Muaji 2 | Java 3/Muaji 3 | Java 4/Muaji 4 | Java 5/Muaji 5 |
| 1. | | | | | | |
| 2. | | | | | | |
| 3. | | | | | | |
| 4 | | | | | | |

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik ofertues lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NP - 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale.
- NS - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën **ISO 9001** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën **ISO 45001** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.4 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeje Urbane”, sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion;

- Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022 dhe në vazhdim, dhe të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022.

Shënim: *Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022 dhe në vazhdim, specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë.

Për specialistin e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022.

Shënim: *Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 29 (njëzet e nëntë) punonjësve për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022.

-
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022 dhe në vazhdim, minimumi:

- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës elektrikistë
- 2 (dy) punonjës muratorë/suvatues
- 1 (një) punonjës bojaxhi
- 1 (një) punonjës mekanik
- 2 (dy) punonjës specialistë për punime duralumini plastik

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional);
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022.

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1(një) punonjës i cili të jetë i pajisur me çertifikatën e trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022 dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për

sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/liçensuara.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës i cili të jetë pajisur me çertifikatën e trajnimit “Për punimet në lartësi” ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier” dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Qershor 2022 - Korrik 2022 dhe në vazhdim. Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/ liçensuara.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3.9 Në mënyrë që të garantohet furnizimi me materialet objekt të prokurimit që nevojiten për realizimin e kontratës, operatori ekonomik ofertues për materialet (parket, dritare duralumini plastik, bojë akrilike, prozhektorë, përcjellës, automatë), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF) ose autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar. Në rast paraqitje deklarate nga distributori i autorizuar duhet të paraqitet akti i marrëveshjes midis prodhuesit dhe distributorit. Në deklaratën e furnizimit duhet të deklarohet marrja përsipër e furnizimit me mallrat e përcaktuara në këtë kriter për sasinë, cilësinë dhe afatet e parashikuara nga autoriteti kontraktor në DST.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3.10 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet (parket, dritare duralumini plastik, bojë akrilike, prozhektorë, përcjellës, automatë), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/ distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues për materialet (parket, dritare duralumini plastik, bojë akrilike, prozhektorë, përcjellës, automatë), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, që do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës për të cilat kërkohen shprehimisht standarte teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë Deklaratë/Çertifikatë Konfirmimiti CE ose raporte testimi për këto produkte, të lëshuara nga një organizëm i notifikuar europian / organizëm çertifikues i akredituar ose raporte testimi të lëshuara nga organizma të notifikuar europian / organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.

Shënim: Ky kriter (2.3.11) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

| Nr. | Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike | Sasia minimale | Gjendja |
|-----|---|----------------|---------------------|
| 1 | Kamion 3.5 -5ton | 1 copë | Pronësi ose me qira |
| 2 | Kamion me vinç | 1 copë | Pronësi ose me qira |
| 3 | Skeleri metalike | 100 m2 | Pronësi ose me qira |
| 4 | Gjenerator ≥ 5kw | 1 copë | Pronësi ose me qira |
| 5 | Depozitë uji 1000-3000lt | 1 copë | Pronësi ose me qira |
| Nr. | Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse | Sasia minimale | Gjendja |
| 1 | Helmetë mbrojtëse për kokën | 29 copë | Pronësi ose me qira |
| 2 | Jelekë me shirita fosforishentë | 29 copë | Pronësi ose me qira |
| 3 | Fikëse zjarri të lëvizshme ≥ 5kg | 4 copë | Pronësi ose me qira |
| 4 | Tabela Sigurimi Teknik | 12 copë | Pronësi ose me qira |
| 5 | Kuti e Ndihmës së shpejtë | 2 copë | Pronësi ose me qira |

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Shtojcës 8.

Shënim: Ky kriter (2.3.12) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

SHËNIM: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.....

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), brenda afatit 5 (pesë) ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

| Identifikimi | Përgjigja |
|--|--------------|
| Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ----- |
| Numri NIPT/et: | ----- |
| Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar | ----- |
| Përfaqësuesi (emri): | ----- |
| Telefoni: | ----- |
| E-mail: | ----- --- |

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)

| | | | |
|---|-----------------|------------------------------------|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: | | | |
| • Informacione për nënkontraktorin | | | |
| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT – i | Përqindja e nënkontraktimit | Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
| | | | |
| | | | |

| | | | |
|--|---------------|---|---|
| | | | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik | | | |
| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| | |
|--|---|
| Deklarata | Referencat (kur janë të zbatueshme) |
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] |

| | |
|---|---|
| <p>data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> | <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjisllacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

| Deklarata | Përgjigje |
|--|----------------------|
| <p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p> | <p>_____</p> |
| <p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</p> | <p>Po []</p> |
| <p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p> | <p>Po []</p> |
| <p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p> | <p>Po []</p> |
| <p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p> | <p>Po []</p> |
| <p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p> | <p>Po []</p> |
| <p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p> | <p>Po [] Jo []</p> |
| <p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p> | <p>Po [] Jo []</p> |

| | |
|---|----------------------|
| <p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p> | <p>Po [] Jo []</p> |
| <p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p> | <p>Po [] Jo []</p> |
| <p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p> | <p>Po [] Jo []</p> |

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

| |
|---|
| <p>Deklarata</p> |
| <p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> |
